




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Urban FM-Prizren
Dren Xhema
Drejtor
Prizren

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2024/26 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Radio Urban FM-Prizren (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datë 17 maj 2019 është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Prishtinë. Me marrjen e Licencës Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datë 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejt dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. Pala përgjegjëse, me datë 29 janar 2024, ka dorëzuar në KPM një kërkesë për ndryshim të pronësisë dhe gjatë vlerësimit të kësaj kërkesë vërehet se në certifikatën e biznesit të Palës përgjegjëse ka ndryshim në pronësi ku tani si pronarë figurojnë z. Arientin Abdyli dhe z. Tahir Bivolaku. Pra në vend të z. Abduselam Ramadani tani si bashkëpronar figuron z, Tahir Bivolaku. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit ka verifikuar këtë në faqen e internetit të Agjencisë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe është konstatuar se biznesi me emrin tregtar “Radio Urban FM” O.P. në të cilin është lëshuar licenca e Palës përgjegjëse ka ndryshim në pronësi pa miratim paraprak me shkrim nga KPM.
4. KPM, bazuar në Raportin e departamentit të licencimit të datës 14 shkurt 2024 ka gjetur se Pala përgjegjëse, ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Analiza ligjore

5. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të Ligjit të KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

6. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.”

7. Në kundërshtim me nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2021/01, i cili përcakton se:

“ Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen pa autorizim dhe pa aprovim paraprak me shkrim nga KPM”.

8. Në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2 dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, i cili përcakton se:

2. “I licencuari nuk mund të bartë licencën ose frekuenc-ën(at) pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së.”

2.1. “Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së.”

2.2. “Kjo kërkesë do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimit të udhëheqësisë së të licencuarit, që është regjistruar si OJQ, në përputhje me Rregulloren e KPM-së për Kriteret Kualifikuese për Marrjen e Licencës. Në rastin kur KPM lejon transferimin e Licencës, në asnjë rrethanë nuk do të paguhet e as të pranohet asnjë kompensim financiar për transferimin e kësaj licence.”

3. “Kontrolli Efektiv i Frekuencës: I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë, plotësisht ose pjesërisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.”

9. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse, ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së.

10. KPM duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 21 paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, nenit 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, nenit 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2, dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, duke bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së.

Vendim

11. Pala përgjegjëse, sanksionohet me **Gjobë** në shumë prej njëmijë (1.000) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18 Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale-KPM-2021/01, nenit 5, paragrafin 5.2, dhe paragrafin 5.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

12. Pala përgjegjëse obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi ta dorëzojë kërkesën së bashku me dokumentet e nevojshme për ndryshim të pronësisë, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 21, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2, dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

13. Pala Përgjegjëse, obligohet që gjobën në shumë prej njëmijë (1.000) euro e përcaktuar nga pika 11, e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në xhirrolloarinë e KPM-së numër: 1000400070001635.

14. Në rast se Pala Përgjegjëse nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar në pikën 13 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbarimore.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar



15.04.2024

Datë